

VENDIM
Nr. 251, datë 11.12.2018

MBI MIRATIMIN E DISA AMENDIMEVE PËR PROPOZIMIN E TË GJITHË OST-ve
MBI “UDHËZUESIN PËR KËRKESAT ORGANIZATIVE, ROLET DHE
PËRGJEGJËSITË NË LIDHJE ME SHKËMBIMIN E TË DHËNAVE” (KORP)

Në mbështetje të neneve 7, 16, 56 dhe 63, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 40, pika 6, të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian BE 2017/1485, “Mbi Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (SO GL)”, nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.12.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, për miratimin e disa amendimeve për propozimin e të gjitha OST-ve mbi “Udhëzuesin për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP),

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 159, datë 9.7.2018, ka miratuar “Udhëzuesin për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP).

- Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (OST sh.a.), me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 674 prot., datë 22.10.2018, ka përcjellë për miratim, amendimet për propozimin e të gjitha OST-ve mbi këtë udhëzues.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 233, datë 2.11.2018, filloi procedurën për miratimin e amendimeve për propozimin e të gjitha OST-ve mbi “Udhëzuesin për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP).

- ERE, me shkresën nr. 55/67 prot., datë 2.11.2018, ka publikuar në median e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 674/1 prot., datë 6.11.2018, ka dërguar këtë vendim pranë palëve të interesit.

- Këto amendime janë propozuar nga Autoritetet Rregullatore të vendeve anëtare të BE-së sipas marrëveshjes së arritur në Forumin e Rregullatorëve të Energjisë, më 23 korrik 2018. Në përputhje me këtë marrëveshje, amendimet i janë përcjellë dhe njëherë ENTSO-E për konsultim dhe aprovim nga anëtarët e saj.

- Nga ENTSO-E, në cilësinë e hartuesit të KORP, në datën 9 tetor 2018, u krye votimi në lidhje me këto amendime, i cili rezultoi në favor të miratimit të tyre.

- Amendimet mbi “Udhëzuesin për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP), janë bashkëlidhur këtij vendimi dhe konsistojnë kryesisht në një sistemim sintaksor dhe leksik më të mirë të strukturës së këtij udhëzuesi, me qëllim kuptimin më të mirë nga ana e palëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë amendimet për propozimin e të gjitha OST-ve pjesëtare të ENTSO-E, mbi “Udhëzuesin për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP). (Bashkëlidhur udhëzuesi i amenduar.)

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht) ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti